



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 21. 10. 2008, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Mungonin: Drita Maliqi që ishte në udhëtim zyrtar, si dhe Naim Rustemi në Mitrovicë në manifestimin *Java e Kuvendit të Republikës së Kosovës*.

Mbledhjen e monitoruan: përfaqësuesi i Kryesisë së Kosovës dhe përfaqësuesja e OSBE-së.

- Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Caktimi i datës për mbajtjen e dëgjimit publik lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për barazi gjinore nr. 2004/ 18,
- 3 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 4 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Caktimi i datës për mbajtjen e dëgjimit publik lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore nr. 2004/ 18

Kryetari – Ceku se Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia për Barazi Gjinore nuk kanë ofruar informata lidhur me përgatitjen e dëgjimit publik që do të zhvillohet në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar. Me tutje tha se dëgjimi do të mbahet nga mesi i nëntorit 2008, në mënyre që të përgatitemi për ndryshimet dhe plotësimet që do t'i bëhen Ligjit për barazi gjinore nr. 2004/ 18 dhe njëherësh u pajtuan për mbajtjen e dëgjimit publik.

3. Shqyrtimi i disa peticioneve

Nerxhivane Dauti – Në cilësi të raportueses lidhur me përmbajtjen e peticioneve theksoi si vijon: Në shkresën nr. 03/1062 /D0 – 665, të datës 26. 9. 2008, të ushtruar nga NSH “Barnatorja III e Prishtinës”, në të cilën theksohet se kjo organizatë është themeluar para 50 vjetëve. Ndërtesa e barnatores është në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës. Për shkak të statusit të saj kontestues të pronësisë, kërkohet nga OEK lirim i saj.

Në shkresën nr 82/08 kërkohet mbrojtja sociale, ekonomike dhe të nxirret ligji i pensionimit të parakohshëm, sipas të cilit do të realizoheshin të drejtat e pensionimit pas moshës 35-vjeçare. Peticioni është nënshkruar nga 75 persona.

Punëtorët e Ndërmarrjes Botuese “Rilindja” kërkojnë kompensimin e pagave që ish-ministri i Kulturës ua pat ndërprerë arbitrarisht të ardhurat personale gjashtë punëtorëve të NB “Rilindja”. Gjithashtu, pa njoftim, e kishte mbyllur zyrën e NB “Rilindja”. Për këtë janë njoftuar të gjitha institucionet e Kosovës. Theksohet se punëtorët janë në gjendje të vështirë dhe botojnë me vetësponsorim të autorëve, pa asnjë përkrahje institucionale. Ata kërkojnë drejtësi nga institucionet përkatëse dhe të futen në listën e pagave.

Lidhur me shkresat u zhvillua një debat i deputetëve: Vezira Emrush, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Ismet Beqiri, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Shpresa Murati, Radmila Vujovic dhe Nerxhivane Dauti. U pajtuan që Komisioni t'i ftonë në mbledhje ushtruesit e peticioneve që të dëgjohen përmbajtjet e peticioneve.

Vezira Emrush – Lidhur me peticionet e akuzoi Qeverinë për neglizhencë dhe për papërgjegjësi lidhur me veprimet e Agjencisë së Privatizimit që nuk i ka përmbushur detyrimet ndaj punëtorëve gjatë privatizimit. Ajo kërkoi që këto kërkesa të përmbushen, ngase është edhe detyrë jona t'i mbrojmë edhe interesat e tyre.

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësve nuk u pajtua me një pjesë të diskutimit të saj. Kontribuoi për zgjidhjen e problemeve të shumta që po e përcjellin shoqërinë tonë.

Hajredin Hyseni – Diskutoi për format e privatizimit. Ua përkujtoi detyrimet që i morën përsipër me rastin e privatizimit, që sa më parë të fillojë pagesa e tyre.

Ne fund te kësaj pike kryetari e falënderoi raportuesen për punën e bërë për shqyrtimin e peticioneve.

4. Te ndryshme

Komisioni debatoi për disa çështje që i përkasin fushëveprimit të tij.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri